



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.67

31 maj

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.7005 datë 20.5.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	2687
Vendim i KM nr.344, datë 29.4.2011	Për miratimin e rregullores “Për sigurimin fizik të materialeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”	2687
Vendim i KM nr.345, datë 29.4.2011	Për disa ndryshime në vendimin nr.554, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për fondin e ekselencës për mbështetje financiare të studentëve e shkencëtarëve të rinj, të shkëlqyer”	2692
Vendim i KM nr.346, datë 29.4.2011	Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”	2692
Vendim i KM nr.350, datë 29.4.2011	Për miratimin e planveprimit për zgjidhjen e problematikës së çështjeve të pronësisë, e identifikuar në Memorandumin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës	2697
Vendim i KM nr.351, datë 21.4.2011	Për mënyrën e funksionimit të Këshillit të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe të Sekretariatit Teknik	2702
Vendim i KM nr.353, datë 4.5.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qafë-Kashar-Rinas	2704
Udhëzim i MF nr.12/1, datë 26.5.2011	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.12, datë 18.5.2011 “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor””	2706
Udhëzim i MF nr.13, datë 26.5.2011	Për një ndryshim në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar	2707

DEKRET
Nr.7005, datë 20.5.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Memet Silman Duymaz
2. Hikmet Ali Yildirim
3. Shkurte Bajram Alikaj (Sylejmani)
4. Hasan Bayram Nuka
5. Zeynep Hamza Ikkardeş
6. Kasim Ahmet Ilhan

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.344, datë 29.4.2011

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR SIGURIMIN FIZIK TË MATERIALEVE
RADIOAKTIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për sigurimin fizik të materialeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR SIGURIMIN FIZIK TË MATERIALEVE RADIOAKTIVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 1

Objekti

1. Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e masave për sigurimin fizik të materialeve radioaktive, të transportimit, si dhe kërkesat për mbajtjen në vende të sigurta të burimeve radioaktive dhe përdorimin e tyre vetëm nga persona juridikë e fizikë të licencuar për veprimtari përkatëse sipas akteve ligjore dhe nënligjore.

2. Burimet radioaktive përdoren vetëm pasi të jenë plotësuar të gjitha kërkesat e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR) lidhur me licencimin e tyre, me qëllim parandalimin e humbjes së kontrollit ndaj tyre. Burimet radioaktive nuk mund të transferohen te persona që nuk zotërojnë licencë të vlefshme për përdorimin e këtyre burimeve të lëshuar nga KMR-ja.

Neni 2

Qëllimi

1. Sigurimi fizik i burimeve radioaktive ka si qëllim mbrojtjen e tyre ndaj vjedhjeve ose veprimtarisë së kundërligjshme, si dhe parandalimin e ekspozimit të publikut.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Sigurimi fizik i burimeve radioaktive dhe kategorizimi i tyre në lidhje me këtë sigurim bëhet duke mbajtur parasysh këto parime kryesore:

a) Projektimin e pajisjes dhe të burimit në mënyrë që të minimizohet mundësia e kryerjes së veprimtarive të kundërligjshme.

b) Menaxhimin e burimeve vetëm me licencë të lëshuar nga KMR-ja dhe në përputhje me kuadrin ligjor për sigurinë dhe sigurimin fizik të tyre.

c) Marrjen e masave për parandalimin e hyrjeve të paautorizuara te burimet radioaktive.

d) Marrjen e masave për shmangien e vjedhjeve ose humbjeve të burimeve, si dhe për reagimin e menjëhershëm ndaj këtyre veprimtarive.

Neni 4

Masat për sigurimin fizik të burimeve radioaktive

1. Referuar kategorizimit të burimeve radioaktive, krijohen grupet e sigurimit fizik të burimeve radioaktive me qëllim krijimin e një sistemi të përshtatshëm të sigurimit fizik, si më poshtë:

a) grupi i sigurimit fizik A, ku përfshihen burimet e kategorisë së parë;

b) grupi i sigurimit fizik B, ku përfshihen burimet e kategorisë së dytë dhe të tretë;

c) grupi i sigurimit fizik C, ku përfshihen burimet e kategorisë së katërt;

d) grupi i sigurimit fizik D përfshihen burimet e kategorisë së pestë.

Neni 5

Burimet radioaktive të grupit A

1. Për burimet radioaktive të kategorisë së parë, që i përkasin grupit A të sigurimit fizik, duhet të sigurohet zbatimi i këtyre masave:

a) Kontrolli fizik i përditshëm i burimeve nga ana e përdoruesit. Përdoruesi krijon inventar, i cili firmoset çdo ditë nga ana e tij për prezencën fizike të burimit.

b) Kontrolli i burimeve me kamera televizive me qark të mbyllur. Të vëzhgohet në çdo moment nga një qendër kontrolli dhe regjistrohet duke ruajtur të dhënat të paktën dhe një muaj pas regjistrimit.

c) Zbatimi i dy masave teknike mbrojtëse ndaj hyrjes së personave të paautorizuar, si derë me dy çelësa ku secili çelës mbahet nga persona të ndryshëm.

d) Hartimi i planit të posaçëm të emergjencës, i cili përmban procedurat për njoftimin e shpejtë, për masat reaguese dhe për informimin e publikut. Ky plan duhet të testohet dhe të përditësohet në mënyrë periodike.

e) Kontrolli i veprimtarisë së personelit, informacioni që mund të përdoret për identifikimin e burimit, masa të posaçme sigurie që administrohen në mënyrë konfidenciale për datat e transportit ose zhvendosjes së burimit, si dhe planin për rritjen e sigurisë në rastin e rritjes së shkallës së kërcënimit.

f) Ruajtja dhe sigurimi i objekteve/ambienteve ku mbahen lëndët radioaktive, si dhe shoqërimi i tyre gjatë transportit të kryhet nga punonjësit e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.

g) Transporti i burimit, duke u bazuar në besueshmërinë e kompanisë transportuese, në realizimin e paketimeve të mbyllura dhe të vulosura, në komunikimin e vazhdueshëm të personelit transportues me organet e rendit. Në sigurimin e personelit të gatshëm të reagimit dhe në një plan emergjence që parashikon masat reaguese gjatë aksidenteve të transportit.

Neni 6

Burimet radioaktive të grupit B

1. Për burimet radioaktive të kategorisë së dytë dhe të tretë që i përkasin grupit B të sigurimit fizik duhet të sigurohet zbatimi i këtyre masave:

a) Kontrolli fizik i përjavshëm i burimeve nga ana e përdoruesit. Përdoruesi krijon inventar, i cili firmoset çdo javë nga ana e tij për prezencën fizike të burimit.

b) Kontrolli i vendndodhjes së burimeve me sensorë alarmi.

c) Zbatimi i dy masave mbrojtëse, nga të cilat njëra duhet të jetë teknike.

d) Hartimi i planit të posaçëm të emergjencës, që duhet të përmbajë procedurat për njoftimin e shpejtë, për masat reaguese dhe për informimin e publikut. Ky plan duhet të testohet dhe të përditësohet në mënyrë periodike.

e) Kontrolli i veprimtarisë së personelit, informacione që mund të përdoren për identifikimin e burimit, masa të posaçme sigurie që administrohen në mënyrë konfidenciale si datat për transportin ose zhvendosjen e burimit, si dhe planin për rritjen e sigurisë në rastin e rritjes së shkallës së kërcënimit.

f) Ruajtja dhe sigurimi i objekteve/ambienteve ku mbahen lëndët radioaktive, si dhe shoqërimi i tyre gjatë transportit të kryhet nga punonjësit e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.

g) Transporti i burimit të bëhet në përputhje me kërkesat për sigurimin e tij, sipas grupit të sigurisë dhe të ketë komunikim të vazhdueshëm me personelin transportues për të pasur mundësinë e reagimit në rast aksidenti ose kërcënimi të mundshëm gjatë transportit, të burimeve radioaktive të grupit të sigurisë A dhe B.

Neni 7

Burimet radioaktive të grupit C

1. Për burimet radioaktive të kategorisë së katërt që i përkasin grupit C të sigurimit fizik duhet të sigurohet zbatimi i këtyre masave:

a) Kontrolli fizik i burimeve, bazuar në rrezikun që ata paraqesin, dy herë në vit nga ana e përdoruesit.

b) Kontrolli i vendndodhjes së burimeve me sensor alarmi.

c) Zbatimi i një mase teknike mbrojtëse.

d) Hartimi i planit të emergjencës së përgjithshme.

e) Transporti i burimit, në përputhje me kërkesat për sigurimin e tij, në komunikimin e vazhdueshëm me personelin transportues për të pasur mundësinë e reagimit në rast incidenti ose kërcënimi të mundshëm gjatë transportit.

Neni 8

Burimet radioaktive të grupit D

Për burimet radioaktive të kategorisë së pestë, që i përkasin grupit D të sigurimit fizik, duhet të sigurohet zbatimi i kontrollit fizik të burimeve, në përputhje me planin e mbrojtjes nga rrezatimi.

Neni 9

Masat administrative dhe teknike të sigurimit fizik të burimeve

1. Masat administrative të sigurimit fizik të burimeve përfshijnë:
 - a) Vendosjen e detektorëve të rrezatimit, me qëllim që të zbulohen lëvizjet e paautorizuara të burimeve.
 - b) Kontrollë të veçanta.
 - c) Kamera kontrolluese të personelit dhe ambientit.
 - d) Të dhëna që lidhen me menaxhimin e burimeve.
 - e) Inventari i burimeve, rregulloret dhe udhëzues të ndryshëm në lidhje me sigurimin, bashkëpunimin dhe besueshmëri të personelit, sigurim informacioni, masa për sigurimin e kontrollit të cilësisë dhe një kulturre sigurie dhe sigurimi fizik të burimeve radioaktive.
2. Masat teknike të sigurimit të burimeve radioaktive përfshijnë:
 - a) Vendosjen e rrethimeve.
 - b) Vendosjen e mureve dhe pengesave parandaluese të përshtatshme.
 - c) Paketimin e burimit në përputhje me rregullat e transportit.
 - d) Vendosjen e çelësve të përshtatshëm për dyert dhe kontejnerët mbrojtës.

Neni 10

Përgjegjësitë e komisionit të mbrojtjes nga rrezatimi

1. Trupa rregullatore ka këto përgjegjësi:
 - a) të ketë informacionet e nevojshme dhe të përshtatshme, që tregojnë saktë tipin e burimit radioaktiv, për transferimin e mundshëm të tij si mbetje radioaktive dhe në mbarimin e afatit të licencës. Në çdo rast trupa rregullatore duhet të ketë një sistem të posaçëm që lejon identifikimin dhe gjurmimin e shpejtë të burimit.
 - b) Të sigurojë zbatimin nga përdoruesit të rregulloreve dhe të masave mbrojtëse dhe sigurimit gjatë gjithë kohës që ata janë të licencuar.
 - c) Të zbatojë një program inspektimi, që përfshin verifikimin prej saj të programeve të mbrojtjes nga rrezatimi dhe të menaxhimit të burimeve radioaktive sipas rregulloreve.

Neni 11

Përgjegjësitë e përdoruesve

1. Personat juridikë e fizikë të licencuar për veprimtaritë që lidhen me burimet radioaktive kanë përgjegjësi për:
 - a) Zbatimin e të gjitha masave administrative dhe teknike të nevojshme për përmbushjen e sigurisë dhe sigurimit fizik të burimeve të licencuara;
 - b) Sigurimin e menaxhimit të të gjitha burimeve radioaktive në përputhje me kërkesat e licencës;
 - c) Magazinimin e burimeve radioaktive që nuk janë në përdorim në përputhje me kërkesat për sigurinë dhe sigurimin fizik të grupit në të cilin ata bëjnë pjesë;
 - d) Dokumentimin e transferimit të burimit radioaktiv te persona të licencuar;
 - e) Sigurimin e mjeteve të nevojshme financiare për menaxhimin e sigurt të burimeve në institucionet përkatëse pasi burimi të ketë dalë nga përdorimi;
 - f) Marrjen në ngarkim të burimeve radioaktive sipas kërkesave të KMR-së;
 - g) Inventarizimin e të gjitha burimeve radioaktive që janë në ngarkim të tij;
 - h) Sigurimin e procedurave të auditimit dhe kontrollit të burimeve radioaktive si në vendet e punës ashtu dhe në ato të ruajtjes.

Neni 12

Raportimi

1. Personat fizikë dhe juridikë të licencuar duhet të raportojnë në KMR për:
 - a) Humbjen e burimeve radioaktive në ngarkim;
 - b) Përdorimin e paautorizuar të burimeve radioaktive;

- c) Veprimet e mundshme keqbërëse që kërcënojnë sigurimin fizik të burimeve radioaktive;
- d) Gabimet që kanë ndodhur në pajisjet që përmbajnë burime radioaktive;
- e) Zbulimin e ndonjë burimi radioaktiv;
- f) Njoftimin e menjëhershëm të KMR-së për çdo aksident që lidhet me humbjen ose moslokalizimin e burimeve radioaktive.

Neni 13 **Burimet jetime**

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet (KMR) mbështetet nga ana e Qendrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar (QFBZ) për vendosjen nën kontroll të të gjitha burimeve jetime. QFBZ-ja kryen të gjitha procedurat për sigurinë dhe sigurimin e burimeve me status jetim deri në vendosjen në depon e kësaj qendre. Shpenzimet në çdo rast mbulohen nga shteti për sa kohë nuk gjendet pronari i burimit.

Neni 14 **Bashkëpunimi me organet e rendit**

1. Të gjitha masat e mësipërme janë në kushtet ekzistuese të shkallës së kërcënimit në vendin tonë. Me rritjen e shkallës së kërcënimit në vendin tonë, Policia e Shtetit, në bashkëpunim me institucionet e linjave përkatëse përcakton masat shtesë për përdoruesit e burimeve radioaktive si ato e shohin të nevojshme. Këto masa janë të detyrueshme për zbatim nga ana e përdoruesve.

2. Pranë KMR-së thirren dy ekspertë të sigurisë fizike, nga të cilët njëri të jetë përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilët bëjnë vlerësimin e sigurimit fizik mbi bazën e kësaj rregulloreje dhe kushteve minimale të kërcënimit. Përfaqësuesi i Policisë së Shtetit paraqet në KMR masat shtesë në rastin e rritjes së shkallës së kërcënimit.

Neni 15 **Bashkëpunimi me doganat**

Me qëllim sigurimin e kufijve për të mos lejuar hyrje-dalje dhe transitin e paautorizuar të burimeve radioaktive në Republikën e Shqipërisë, doganat shqiptare të marrin të gjitha masat për vendosjen e pajisjeve për dedektimin automatik dhe manual të radiobërthamave në kufi. Nëpërmjet këtyre pajisjeve të bëhet dedektimi dhe të përcaktohen planet e reagimit nga ana e doganave. Doganat bashkëpunojnë me KMR dhe QFBZ në lidhje me këto procedura. Doganat të marrin të gjitha masat që pajisjet të jenë funksionale, të kalibruara dhe personeli të ketë njohuritë dhe trajnimin e nevojshëm për reagimin në raste të kalimeve të ligjshme e të paligjshme të burimeve radioaktive ose mallrave të kontaminuara. Doganat të bëjnë dedektimin dhe të marrin të gjithë masat për mbrojtjen e personelit, publikut dhe ambientit, duke caktuar dhe vende të posaçme për kontrollin e detajuar të ngarkesave. Në çdo rast doganat duhet të njoftojnë me shkrim Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimi (ZMR) për çdo lëvizje të paautorizuar.

Neni 16 **Pika e kontaktit me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike**

KMR-ja përcaktohet si pikë kontakti me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike për çështjet e sigurimit të materialeve radioaktive dhe trafikun ilegal. Institucionet janë të detyruara të dërgojnë në ZMR të dhënat sipas formularit standard të përcaktuar nga KMR-ja për burimet e humbura dhe jetimë që mund të gjenden.

VENDIM
Nr.345, datë 29.4.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.554, DATË 7.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FONDIN E EKSELENCËS PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË
STUDENTËVE E SHKENCËTARËVE TË RINJ, TË SHKËLQYER”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 57 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.554, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “b” e pikës 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) bursa të posaçme për studentë, që ndjekin studime “Bachelor” ose “Master” në njërin prej 15 universiteteve më të mira të botës, studentët, që janë pranuar e kanë përfutuar bursë të pjesshme në shkencat inxhinierike, teknologji informacioni, matematikë, fizikë dhe bioteknologji në universitetet e njohura perëndimore, si dhe ata që ndjekin studimet “Bachelor” ose “Master” në artet e bukura;”.

b) Shkronja “b” e pikës 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Studentët, që ndjekin jashtë shtetit ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve kur:

i) janë pranuar në njërin nga 15 universitetet më të mira të botës për të ndjekur njërin nga dy ciklet e studimit ose janë pranuar dhe kanë përfutuar bursë të pjesshme në shkencat inxhinierike, teknologji informacioni, matematikë, fizikë dhe bioteknologji në universitetet e njohura perëndimore, si dhe ata që janë pranuar të ndjekin studimet në artet e bukura;

ii) pranojnë të punojnë, së paku, 3 (tre) vjet në Shqipëri, ose të bashkëpunojnë me institucionet publike ose me sektorin privat të vendit, në forma të ndryshme, pas përfundimit të ciklit përkatës të studimeve, për të cilin përfitojnë bursën, ose pas përfundimit të të gjithë ciklit të studimeve, nëse kandidati përfitues vijon studimet;

iii) nuk janë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar dhe nuk kanë të ardhura personale mbi 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë në muaj.”.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.346, datë 29.4.2011

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
AGJENCISË SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 36 të ligjit nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SHTETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS

Neni 1

Misioni, statusi juridik, stema, logoja dhe vula e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

1. ASHMDF-ja ka për mision të monitorojë zbatimin e ligjit nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, si dhe të garantojë në bashkëpunim me autoritetet e tjera shtetërore përgjegjëse dhe organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, realizimin me efektivitet të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si dhe përkujdesjen e posaçme ndaj tyre.

2. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, më poshtë ASHMDF, organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit dhe të këtij vendimi, si person juridik në varësi të ministrit që bashkërendon punën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, dhe e ka selinë në Tiranë.

3. ASHMDF-ja ka stemë, logon dhe vulën zyrtare.

4. Stema përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria përgjegjëse që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”.

5. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve ka vulën e vet zyrtare, e cila ka formën dhe përmban elementet e përcaktuara në pikën 2 të vendimit nr.390, datë 6.8.1993 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare”, të ndryshuar.

Vula e ASHMDF-së ka shënimin identifikues “Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”.

6. Vula e ASHMDF-së administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Logoja e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve miratohet me urdhër të ministrit që bashkërendon punën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Neni 2

Parimet e veprimtarisë së Agjencisë

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, ushtron veprimtarinë e saj:

a) në përputhje me ligjin nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” dhe parimet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

b) si dhe mbështetur në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Neni 3

Funksionet e Agjencisë

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës realizon misionin e saj përmes funksionit:

a) të monitorimit të zbatimit të ligjit nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” dhe legjislacionit në fuqi, si dhe të koordinimit të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të strategjive dhe politikave në fushën e të drejtave të fëmijëve;

b) propozimit në ministrinë që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për ndërhyrje në politika dhe legjislacion, bazuar në problematikat që kanë dalë gjatë monitorimit të zbatimit të ligjit, strategjive dhe politikave në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

c) propozimit për udhëzime metodologjike për njësitë e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës në organet e qeverisjes vendore;

ç) të mbështetjes teknike për strukturat e organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe për organizatat jofitimprurëse, që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

d) të koordinimit me të gjitha strukturat e qeverisjes qendrore dhe vendore për përgatitjen e raporteve, informacioneve dhe statistikave për gjendjen e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri;

dh) të ndëshkimit ndaj subjekteve të cilat shkelin dispozitat e ligjit nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

Neni 4

Organizimi, drejtimi dhe administrimi i ASHMDF-së

1. ASHMDF-ja drejtohet nga kryetari/ja i/e Agjencisë, si autoriteti më i lartë ekzekutiv i saj, dhe përgjigjet për aktivitetin e Agjencisë para ministrit që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

2. Kryetari/ja i/e ASHMDF-së emërohet nga Kryeministri, me propozim të ministrit që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijës, pas përfundimit të një procesi konkurrimi të hapur në përputhje me përcaktimet e vendimit nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin, lirimimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit”.

3. Kryetari/ja i/e ASHMDF-së lirohet nga detyra kur:

a) jep dorëheqjen;

b) gjatë ushtrimit të detyrës dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë;

c) është në pamundësi fizike a mendore të dokumentuar nga komisionet mjekësore përkatëse për të kryer funksionet e ngarkuara;

ç) rezulton i paaftë për të drejtuar ASHMDF-në pas vlerësimit nga ministri që bashkërendon çështjet për mbrojtje e të drejtave të fëmijës, të raportit vjetor të veprimtarisë së Agjencisë;

d) kur ndaj tij merret masa disiplinore “Largim nga puna”.

4. Kryetari/ja i/e ASHMDF-së ka këto kompetenca:

a) përfaqëson Agjencinë në marrëdhënie me autoritetet shtetërore përgjegjëse dhe me të tretët;

b) propozon te ministri që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, rregullore të brendshme të strukturës organizative të Agjencisë. Në rregulloren e brendshme përcaktohen rregullat e funksionimit të sektorëve, detyrat dhe përsëkrimet e pozicioneve të punës për çdo specialist etj., nëpërmjet të cilave ushtrohet aktiviteti i përditshëm i Agjencisë;

c) emëron dhe liron nga detyra, pas miratimit nga ministri që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, nëpunësit e ASHMDF-së;

ç) miraton kriteret e veçanta të marrjes në punë të nëpunësve të ASHMDF-së dhe përsëkrimin e vendeve të punës;

d) harton dhe propozon te ministri që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës buxhetin e Agjencisë;

dh) nxjerr urdhra të brendshëm, të detyrueshëm për menaxhimin administrativ dhe financiar të Agjencisë;

e) miraton programin e brendshëm të veprimtarisë periodike të Agjencisë, sipas detyrave të përcaktuara në nenin 37 të ligjit nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” dhe i raporton ministrit për realizimin e këtij programi;

ë) miraton programet kualifikuese e trajnuese për edukimin, ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe të punonjësve e të funksionarëve të administratës publike e të sistemit gjyqësor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera.

Neni 5 **Funksionimi i Agjencisë**

1. Agjencia përmbush objektivat, kryen detyrat dhe ushtron përgjegjësitë e përcaktuara në ligjin nr.10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

2. ASHMDF-ja nëpërmjet strukturave të saj pranon, ndjek, plotëson, shqyrton apo vlerëson administrativisht, kërkesat e çdo subjekti që informon për shkeljen e të drejtave të një fëmije.

3. ASHMDF-ja, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, është e hapur për publikun, autoritetet shtetërore përgjegjëse të përcaktuara si mekanizma institucionalë dhe në shërbim të subjekteve, gjatë gjithë orarit zyrtar të punës. Çdo kufizim brenda orarit zyrtar, për aplikim, plotësim dokumentacioni, takim, këshillim me punonjësit e Agjencisë, përcaktohet me urdhër të brendshëm të kryetarit të Agjencisë.

4. Të gjithë punonjësit e Agjencisë, që, sipas detyrës funksionale që kanë pranojnë, përpunojnë, plotësojnë, shqyrtojnë, vlerësojnë dokumentacionin për çështje që janë në kompetencë të ASHMDF-së, kanë përgjegjësinë e vlerësimit ligjor të çështjes dhe propozimit në funksion të zgjidhjes së drejtë të saj, si edhe të administrimit, pasqyrimit e dokumentimit të çdo të dhëne e veprimi teknik apo procedural, të kryer në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

5. Evidentimi i të gjitha veprimeve procedurale, sipas pikës 4 të këtij neni, kryhet nëpërmjet përfshirjes në dosje të çdo shkrese, që i bashkëlidhet praktikës, si dhe nëpërmjet depozitimit të të gjitha procesverbaleve, kujtesave, informacioneve, akteve të vlerësimit, vlerësimeve ligjore të përgatitura, sipas rastit apo çdo shkresë tjetër të brendshme apo për të tretët, lidhur me trajtimin e kërkesës.

Neni 6 **Financimi i Agjencisë**

1. ASHMDF-ja për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së saj financohet nga buxheti i shtetit.

2. ASHMDF-ja për fondet që mund të sigurojë nga donatorë të ndryshëm vendas apo ndërkombëtarë, për të përmbushur detyrat dhe funksionet e saj, brenda 7 ditëve njofton ministrin që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijës. Fondet e siguruar nga donatorët bëhen pjesë e buxhetit të Agjencisë.

Neni 7 **Përzgjedhja e punonjësve të Agjencisë**

1. Për nëpunësit e ASHMDF-së emërimi dhe lirimi bëhet nga kryetari/ja e Agjencisë.

2. Përzgjedhja e nëpunësit i nënshtrohet procedurave të konkurrimit të hapur.

3. Kryetari/ja e Agjencisë urdhëron shpalljen e vendit të lirë në Buletinin e Njoftimeve Publike pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, si dhe në faqen e internetit të Ministrisë, të paktën 15 ditë para datës së konkurrimit.

4. Kandidatët e paraqitur, krahas kërkesave të përgjithshme për t'u punësuar në shërbimin civil, të cilat janë sipas nenit 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, duhet të plotësojnë edhe kërkesat e veçanta. Kërkesat e veçanta miratohen nga kryetari i Agjencisë.

5. Procedura e testimit miratohet me akt administrativ të kryetarit/es të/së ASHMDF-së.

6. Kryetari i Agjencisë përzgjedh njërin nga dy kandidatët fitues.

7. Procedurat e liritimit për nëpunësit e ASHMDF-së rregullohen në përputhje me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës, dhe të akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

8. Marrëdhëniet juridike të punës së nëpunësve të ASHMDF-së fillojnë me aktin e emërimit, i cili nënshkruhet nga kryetari/ja i/e Agjencisë.

9. Nëpunësit e ASHMDF-së, në momentin e punësimit të tyre, mund t'i nënshtrohen një periudhe prove sipas përcaktimeve të legjislationit në fuqi, për të provuar aftësitë e tyre për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në përshkrimin e vendit të punës.

10. Marrëdhëniet juridike të punës së nëpunësve të Agjencisë pas përfundimit të periudhës së provës, janë pa afat.

Neni 8
Masat disiplinore

1. Për mosplotësimin e detyrave, thyerjen e disiplinës në punë e të rregullave të etikës, si dhe për raste të tjera, të parashikuara në rregulloren e brendshme të Agjencisë, kryetarit/es të/së Agjencisë i jepet masë disiplinore nga ministri, ndërsa nëpunësve të ASHMDF-së nga kryetari/ja e Agjencisë.

2. Masa disiplinore propozohet nga eprori direkt i nëpunësit dhe jepet sipas një procedure administrative, e cila garanton të drejtën për t'u informuar, dëgjuar, mbrojtur dhe ankuar.

3. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore, por nuk është e nevojshme të jepen të gjitha masat disiplinore, përpara masës së largimit nga puna.

4. Llojet e masave disiplinore janë:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) vërejtje me paralajmërim;
- c) pezullim nga e drejta për të konkurruar për ngritje në detyrë;
- d) largim nga puna.

5. Masat disiplinore mund të shlyhen, nëse nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore, brenda:

- a) 1 viti, nga data e dhënies së tyre, për shkronjat "a" e "b" të pikës 4 të këtij neni;
- b) 3 vjetësh, nga data e dhënies së tyre për shkronjën "c" të pikës 4 të këtij neni.

Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake e punonjësit.

6. Ankesat ndaj vendimeve për dhënien e masave disiplinore paraqiten në komisionin e ngritur nga ministri që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, brenda 30 ditëve pune nga data e komunikimit të vendimit. Kryetari ankimohet pranë Kryeministrit.

Neni 9
Marrëdhëniet e Agjencisë me Ministrinë që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

1. Ministri që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, ushtron kontroll në veprimtarinë e Agjencisë.

2. Kryetari/ja e ASHMDF-së raporton në strukturën politikëbërëse për çështjet e fëmijëve në ministri, ministrisë për:

- a) statusin, ecurinë e zbatimit të buxhetit, bilancin financiar, efikasitetin, rezultatet e veprimtarisë së këtij institucioni dhe programet e zbatuara apo që janë në vazhdim;
- b) evidencat statistikore për nivelin qendror, rajonal dhe atë vendor, realizimin e buxhetit, si dhe realizimin e programeve të punës;
- c) propozimet për përmirësime, ndryshime në legjislacion, si dhe për çdo nismë për projekte, studime e bashkëpunime në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

3. Agjencia paraqet në ministrinë që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, propozimet për projektbuxhetin.

4. Agjencia paraqet brenda tre mujorit të parë të vitit pasardhës te ministri që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, raportin vjetor të ASHMDF-së, i cili duhet të përmbajë:

- a) aktivitetin vjetor të Agjencisë për detyrat e përcaktuara në ligjin nr.10 347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës".
- b) ligjet dhe rregullat për të cilat nuk është folur në raportet e mëparshme, që kanë të bëjnë me fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve;
- c) personelin e Agjencisë;
- ç) informacion për institucionet e specializuara për fëmijët dhe personat e kontaktit, organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, të dhëna të tjera që lidhen me mbrojtjen e fëmijës;
- d) statistikat e përpunuara gjatë vitit për situatën e të drejtave të fëmijës;
- dh) sanksionet e vendosura gjatë vitit për të cilin raportohet dhe ekzekutimi i tyre;
- e) të dhëna të tjera, që lidhen me aspektet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, të cilat gjykohen të nevojshme nga ministri dhe kryetari/ja i/e Agjencisë.

VENDIM
Nr.350, datë 29.4.2011

**PËR MIRATIMIN E PLANVEPRIMIT PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMATIKËS SË
ÇËSHTJEVE TË PRONËSISË, E IDENTIFIKUAR NË MEMORANDUMIN E KOMITETIT TË
MINISTRAVE TË KËSHILLIT TË EUROPËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut e Memorandumi CH/Inf/DH (2010)20, datë 25 maj 2010 të Komitetit të Ministrave “Për masat strategjike të situatës së pronave në Shqipëri”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e planveprimit për zgjidhjen e problematikës së çështjeve të pronësisë, e identifikuar në memorandumin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen të gjitha institucionet shtetërore të përmendura në tekstin e planveprimit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANVEPRIMI
**PËR ZGJIDHJEN E PROBLEMATIKËS SË ÇËSHTJEVE TË PRONËSISË PARA GJYKATËS
EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

(Memorandumi CH/Inf/DH (2010)20, datë 25 maj 2010 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për masat strategjike për situatën e pronave në Shqipëri)

Duke pasur parasysh çështjet e identifikuara në Memorandumin CH/Inf/DH (2010)20, datë 25 maj 2010 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, propozojnë të merren një sërë masash në funksion të zgjidhjes së problematikës së pronave në Shqipëri.

Në kuadër të çështjeve që kanë si objekt pretendimet e ankuesve shtetas shqiptarë (grupi Driza) për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, që lidhen me të drejtat e ish- pronarëve për kthimin apo kompensimin e pronës në zbatim të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” është konstatuar se cenimi i së drejtës së pronës ndaj individëve shqiptarë ka ardhur si pasojë e pengesave dhe vështirësive për realizimin e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave.

Gjykata Europiane në vendimet e saj për disa raste të përsëritura, ka konstatuar se mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë apo i vendimeve të komisioneve të pronave në kohë të cilat i konsideron si *quasi* gjyqësore, cenon të drejtën e ankuesve për proces të rregullt ligjor sipas nenit 6 dhe të drejtën e pronës sipas nenit 1, protokollit 1 i Konventës Europiane. Gjykata ka vlerësuar, gjithashtu, se sistemi juridik vendas nuk ofron mjete ligjore efektive ankimi për adresimin e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, çfarë përbën cenim të së drejtës së ankuesve për mjete efektive ankimi sipas nenit 13 të Konventës.

Mosekzekutimi i vendimeve të lartpërmendura ka ardhur si pasojë e problemeve dhe vështirësive që hasen:

- Lidhur me zbatimin e ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”;
- Lidhur me procesin e regjistrimit të pronave;
- Lidhur me sigurimin e mjeteve juridike efektive në rastet e mosekzekutimit të vendimeve përfundimtare gjyqësore.

Më konkretisht, problematikat e ndeshura kanë të bëjnë me mungesën e koordinimit ndërinstitucional në qarkullimin e dokumentacionit dhe në ndërveprimin e arkivave të secilit prej tyre, si dhe të proceseve të ndryshme që prekin pronat. Kuadri ligjor për pronat paraqitet mjaft i fragmentuar dhe ka nevojë të konsolidohet dhe të thjeshtohet për të përcaktuar procedura të thjeshta dhe transparente kompensimi. Gjithashtu, nuk ka përfunduar procesi i regjistrimit fillestar i pasurive të paluajtshme në të gjithë territorin e vendit. Aktualisht mungon një hartë kombëtare unike e pronësisë. AKKP-ja nuk ka bazë elektronike unike të dhënash për vendimet, të cilat në vetvete nuk janë të përditësuara, kryesisht në drejtim të ndryshimeve që mund të kenë pësuar në rrugë gjyqësore. Nuk ka përfunduar procesi i legalizimeve për aplikimet e mbetura, si dhe nuk ka përfunduar identifikimi i fondit fizik të pronave që do të shërbejnë për procesin e kompensimit fizik.

Përgjithësisht, për zgjidhjen e problematikës së identifikuar në memorandum pala shqiptare shpreh vullnetin që masa e kompensimit të jetë 100%, duke pasur parasysh pritshmërinë e ligjshme të pronarëve për vite me radhë në këtë drejtim.

Skema e kompensimit është menduar e ndarë në dy pjesë: i) skema kalimtare për vitin 2010 duke reflektuar problematikën më kryesore të identifikuar nga GJEDNJ; dhe ii) skema definitive që përfundimisht do të ofrojë një skemë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë ish-pronarët. Informacion më i detajuar për secilën skemë jepet në vijim.

Në funksion të implementimit të skemës definitive (duke filluar nga janari 2013), më parë parashikohen të ndërmerren disa masa të tjera paraprake, siç trajtohen më poshtë.

Gjithashtu, u konsiderua e drejtë që kompensimi të mos ndërpritej. Kjo pasi do të cenoheshin pritshmëritë e ligjshme të ish-pronarëve, të cilët janë në pritje të kompensimit prej vitesh. Për më tepër, duhet pasur parasysh që procesi i kompensimit financiar ka filluar relativisht vonë, vetëm në vitin 2005. Rrjedhimisht, ka shumë ish-pronarë në pritje të kompensimit nga viti 1993 deri në 2005-ën.

Lidhur me numrin e saktë të subjekteve që kanë vendime kompensimi dhe përcaktimin e faturës financiare për këtë proces, sqarohet se kjo do të bëhet e mundur pasi të regjistrohen të gjithë ish-pronarët në bazën elektronike të të dhënave që pritet të ngrihet, siç parashikohet në planveprim.

Më poshtë, prezantohen pikërisht masat konkrete që propozohen të merren.

A. Masa të përgjithshme lidhur me çështjet e pronësisë

1. Skema e kompensimit

1.1 Skema kalimtare për vitin 2011

Në mars 2011 është miratuar një vendim i Këshillit të Ministrave që parashikon një skemë të thjeshtuar dhe të drejtë për kompensimin e subjekteve. Vendimi në fjalë ka hyrë në fuqi dhe për një periudhë njëmuajore është hapur faza e pritjes së aplikimeve për kompensim. Më pas, njësoj si në vitet paraardhëse, të gjitha aplikimet do të përpunohen dhe do të dilet me vendim brenda një periudhe tremujore. Skema e re është konceptuar të marrë parasysh praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së për Shqipërinë, veçanërisht respektimin e parimeve të barazisë dhe të drejtësisë.

Së pari, vendimi në fjalë nuk parashikon më kufizimet që ekzistonin në vendimet e Këshillit të Ministrave të viteve të kaluara lidhur me subjektet, të cilat mund të aplikonin për kompensim. Çdo subjekt i shpronësuar që ka një vendim kompensimi ka të drejtë të aplikojë për të përfitur nga fondi i kompensimit që është gjendje, përveç atyre që kanë përfitur kompensim monetar në vitet e kaluara.

Gjithashtu, kriteri për kompensim me vlerën e sipërfaqes fikse prej 200 m² është zëvendësuar. Sipërfaqja për kompensim (vlera monetare) është në vartësi të sipërfaqes totale të njohur sipas disa fushave. Më konkretisht kompensimi do të përfitohet, në rend kronologjik, në varësi të sipërfaqes së njohur për kompensim:

- a) Për prona të njohura për kompensim deri në 1 500 m², masa e kompensimit do të jetë 200 m².
- b) Për prona të njohura për kompensim nga 1500 m²-3000 m², masa e kompensimit do të jetë 300 m².
- c) Për prona të njohura për kompensim nga 3000 m²-5000 m², masa e kompensimit do të jetë 400 m².
- d) Për prona të njohura për kompensim nga 5000 m²-10 000 m², masa e kompensimit do të jetë 500 m².
- e) Për prona të njohura për kompensim mbi 10 000 m², masa e kompensimit do të jetë 600 m².

Skema e re synon arritjen e një balancimi proporcional mes pronarëve. Kjo skemë kompensimi me breza synon korrigjimin e disa problemeve që hasen në praktikë. Në praktikë mund të ndodhë, nëse do të zbatohet një skemë kompensimi e pastër me përqindje fikse, që një ish-pronar që disponon një

vendim kompensimi për një pronë të vogël të marrë një shumë të papërfillshme kompensimi për shkak të vlerës së ulët që mund të ketë prona e tij. Nga ana tjetër, mund të ndodhë që pak ish-pronarë që kanë vendime për kompensim në zona ku prona ka vlerë të lartë të shterojnë të gjithë fondin financiar në dispozicion. Duke pasur parasysh këto raste, synohet që të përfitojë një numër i arsyeshëm pronarësh dhe secili prej tyre të marrë një shumë të arsyeshme kompensimi.

Gjithsesi, sa më sipër është në skemë kalimtare kompensimi, e cila do të zëvendësohet nga skema definitive, sipas kriterit me përqindje i korigjuar, siç përshkruhet në vija të përgjithshme më poshtë.

1.2 Skema definitive

Skema e re ligjore për kompensim do të fillojë të operojë në janar të vitit 2013. Deri në këtë moment besohet se shteti shqiptar do të ketë informacion për numrin e subjekteve që kërkojnë kompensim dhe një faturë totale financiare për këtë proces.

Më tej, kjo skemë do të operojë bazuar në një bazë të dhënash të digjitalizuar, sipas të cilave AKKP-ja në kohë reale është në gjendje të kontrollojë situatën hartografike dhe juridike të dosjes, mbi bazën e së cilës janë dhënë vendimet e kompensimit. Mbivendosjet e mundshme hartografike të vendimeve për kompensim do të dalin të qarta nga baza e të dhënave. Ndërtimi i kësaj baze të dhënash parashikohet të jetë në shumën 900 000 euro. Burimi i fondeve pritet të përcaktohet së shpejti.

Nga ana e saj, baza e digjitalizuar e të dhënave e AKKP-së në aspekt hartografik do të ndërtohet (programohet) mbi hartat e standardizuara të prodhuara nga Agjencia Kombëtare për Prodhimin e Hartave të Standardizuara. Duke qenë se të gjitha institucionet do të punojnë me të njëjtin model të standardizuar harte, informacioni hartografik dhe ligjor që ato prodhojnë do të jetë plotësisht i shkëmbyeshëm mes tyre.

Subjektet e shpronësuara që disponojnë vendime kompensimi përfundimtare dhe të ekzekutueshme, brenda një afati prekluziv që do të përcaktohet me ligj, do të shprehin vullnetin e tyre (nëpërmjet një formulari tip të miratuar nga Ministri i Drejtësisë dhe që do të depozitohet në AKKP) për të përfituar kompensim financiar sipas skemës së re.

Skema e re e kompensimit financiar do të funksionojë sipas kriterëve më poshtë:

1. Nga skema do të përfitojnë ish-pronarët që disponojnë vendime për kompensim që janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.

2. Masa e kompensimit do të jetë 100% dhe do të shpërndahet me këste të barabarta. Një masë e tillë kompensimi do të mbetet e pandryshuar për shkak të pritshmërive të ligjshme të subjekteve për vite me radhë, që do të kompensohen në masë të plotë, si dhe duke pasur parasysh që pagesa e kompensimit do të jetë me këste derisa të arrihet kompensimi 100% për çdo pronar.

3. Parashikohet që subjektet që kanë vendime për kompensim përfundimtar dhe të ekzekutueshme duhet të paraqesin një kërkesë sipas një formulari tip (që gjendet tek AKKP-ja apo mund të shkarkohet nga interneti), ku të shprehin vullnetin e tyre për të përfituar kompensimin. Do të pranohen për depozitim ato kërkesa që janë të plota në aspekt formal, duke pasur parasysh kriteret që do të përcaktohen në ligj.

4. Kërkesat e depozituara që pranohen si të plota do të regjistrohen në një bazë elektronike të dhënash në rend kronologjik, duke marrë parasysh jo datën e kërkesës, por datën e vendimit më të hershëm për kompensim për një pronë të caktuar. Nëse një subjekt i shpronësuar disponon vendime kompensimi për prona të ndryshme, mendohet që secili prej tyre të regjistrohet në radhë kronologjike sipas datës që mban, pavarësisht se subjekti i shpronësuar është i njëjti.

5. Në përfundim të periudhës 6-mujore të shprehjes së vullnetit, AKKP-ja kryen procedurat e brendshme për të filluar shpërndarjen efektive të fondit të kompensimit. Në këtë moment do të dihet me saktësi të pranueshme numri i pronarëve që kërkojnë kompensim dhe rrjedhimisht do të mund të vlerësohet fatura financiare.

6. Shteti mendohet të ketë diskrecion me ligj, që të përcaktojë llojin e kompensimit që do të përfitojë subjekti për çdo kësht kompensimi në varësi të fondit fizik apo financiar që ka në dispozicion në momentin kur trajton një subjekt të caktuar. Subjektet nuk do të kenë të drejtë të kërkojnë kompensim në njërën apo tjetrën formë. Në rast se subjekti refuzon të pranojë kompensimin e dhënë, e humbet të drejtën për kompensim për atë kësht/pjesë.

7. Kompensimi do të kryhet automatikisht nga vetë shteti (mbështetur në bazën elektronike të të dhënave), i cili ka si detyrim të vetëkëqutojë me iniciativën e tij vendimet e ashtuquajtura *quasi* gjyqësore (në referim të vendimeve të GJEDNJ-së në çështjet “Beshiri kundër Shqipërisë”, “Bushati

kundër Shqipërisë”, “Scordino kundër Italisë”).

8. Me t'u përcaktuar fatura financiare do të parashikohet dhe një afat konkret se kur mund të përfundojë ky proces.

9. Dhënia e kompensimit në natyrë do të ketë përparësi në raport me dhënien e kompensimit financiar, në mënyrë që të ulet fatura financiare për shtetin.

10. Kompensimi në çdo formë do të jepet për subjektet duke marrë parasysh kriterin kronologjik dhe sipas zonave kadastrale, në të cilat fondi fizik i kompensimit është në dispozicion. Nëse ka fond fizik brenda qarkut ku ndodhet prona e kompensuar, kompensimi fizik do të jepet në këtë qark. Në të kundërt jashtë qarkut, por gjithsesi sa më afër qarkut ku ndodhet prona e kompensuar.

11. Në rast kur ka përplasje mes subjektesh për kompensim mbi të njëjtën pasuri, ata duhet t'i drejtohen gjykatës për zgjidhjen e konfliktit se kujt i takon e drejta e kompensimit për pjesën e mbivendosur të pasurisë brenda afatit prekluziv 1-mujor (njëmuajor) nga momenti i njoftimit nga AKKP-ja për një mbivendosje të tillë. Në të kundërt, të gjitha subjektet në fjalë humbin të drejtën për kompensim për pjesën e mbivendosur. Gjatë kohës së zgjidhjes gjyqësive të çështjes ushtrimi i së drejtës për kompensim pezullohet *ex lege* deri në momentin kur çështja zgjidhet përfundimisht në rrugë gjyqësore dhe AKKP-së i njoftohet vendimi gjyqësor përkatës. Me zgjidhjen përfundimtare të çështjes, subjekti gjyqësor përfiton kompensimin sipas kriterëve të këtij ligji në radhën e ardhshme të kompensimit, kurse çdo subjekt tjetër pjesëmarrës në atë gjykim humb të drejtën për kompensim për atë pasuri.

12. Logjika e pikës 11 do të ndiqet edhe për kompensimin me pjesëmarrje në privatizimin e aksioneve të shoqërive shtetërore.

13. Përcaktimi i fondit për kompensim fizik sistematik do të përfundojë brenda fundit të vitit 2018. Ndërkohë, deri në bërjen efektive të fondit për kompensim fizik sistematik, do të shpërndahet fondi fizik që kohë pas kohe do të jetë gjendje.

14. Skema definitive do të marrë në konsideratë dhe problemet praktike që u trajtuan në kuadër të skemës kalimtare të vitit 2011.

Skema e mësipërme do të jetë pjesë e ndryshimeve që parashikohen të bëhen në ligjin për kthimin dhe kompensimin e pronës deri në fund të nëntorit 2011. Kjo skemë parashikohet të diskutohet gjatë muajve qershor-korrik të këtij viti me ish-pronarët dhe grupet e tjera interesi të interesuara.

Skema definitive e kompensimit do të paraprihet nga disa masa institucionale dhe ligjore:

2. Institucionale

2.1 Në funksion të një koordinimi dhe ecurie më të mirë të problematikës së pronave në Shqipëri do të ngrihet një strukturë pranë Ministrisë së Drejtësisë. Kjo strukturë përgatit, ndjek dhe realizon politikat dhe veprimtaritë që lidhen me hartimin e studimeve në fushën e legjislacionit për të drejtat e pronësisë, kryen dhe përfundon analizat tekniko-ligjore të vlerësimit, të efektivitetit të legjislacionit, harmonizimin tekniko-ligjor të brendshëm të legjislacionit për të drejtat e pronësisë. Për kryerjen e kësaj përgjegjësie, ajo bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë me Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit.

Kjo strukturë, gjithashtu, do të koordinojë institucionet, si: AKKP, ZRPP, ALUIZNI, DASHPP, KQT, Avokatura e Shtetit dhe do të mbikëqyrë e monitorojë procesin e kompensimit të pronave dhe implementimin e masave strategjike të propozuara në planveprimin për çështjet e pronave. Kompetencat dhe detyrat konkrete të kësaj strukture do të dihen në momentin kur të krijohet me ligj (fund nëntori 2011).

Kjo strukturë mendohet të përbëhet nga një staf prej 10 (dhjetë) vetash. Tri prej tyre parashikohen të jenë të nivelit drejtues dhe të tjerët koordinorë (nivel ekzekutiv). Koordinatorët do të kenë si detyrë të krijojnë dhe mbajnë lidhje të vazhdueshme me institucione të ndryshme shtetërore, me qëllim mbledhjen e informacionit dhe qarkullimin e tij në kohë reale në funksion të përsheptimit dhe mbarëvajtjes së procesit të kompensimit të pronave. Informacionet që koordinorët marrin sipas fushës apo institucionit që mbulojnë i përpunojnë dhe analizojnë dhe më pas i qarkullojnë sipas kërkesave të institucioneve të përfshira në procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave. Më tej, koordinorët, në bashkëpunim me AKKP-në do të sigurojnë përditësimin në kohë reale të bazës së të dhënave të AKKP-së.

Kjo strukturë do të fillojë të funksionojë njëkohësisht me hyrjen në fuqi të përmirësimeve ligjore për kompensimin e pronës që synohet brenda nëntorit 2011.

Ngritja e strukturës së koordinimit, do të lehtësojë procesin vendimmarrës, pasi shumë aktorë shtetërorë, të përfshirë në problematikën e pronave, do të jenë të koordinuar nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e kësaj drejtorie. Drejtori i Drejtorisë së Koordinimit, për vetë rëndësinë e problematikës,

mendojmë të zgjidhet nga Kryeministri me propozim të Ministrit të Drejtësisë. Ai do të informojë dhe do t'i raportojë periodikisht Ministrit të Drejtësisë dhe Kryeministrit.

Struktura e koordinimit, ndër të tjera, do të qarkullojë informacionin dhe dokumentacionin e prodhuar nga institucionet e mësipërme në funksion të përditësimit të arkivave të këtyre institucioneve. Rrjedhimisht, marrja apo qarkullimi i informacionit dhe dokumentacionit të domosdoshëm për një proces vendimmarrës pronash do të jetë më i shpejtë. Baza ligore dhe nënligjore, si dhe veprimtaria e kësaj strukture do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Drejtësisë.

2.2 Me vendim të Këshillit të Ministrave do të ngrihet Agjencia Kombëtare për Prodhimin e Hartave të Standardizuara në bazë të propozimeve që kanë dalë nga grupi *ad hoc* i punës i ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr.29, datë 7.3.2011 "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e dokumentit të politikave, të planveprimtaria dhe të kuadrit të nevojshëm ligjor, për organizimin dhe funksionimin e institucioneve përgjegjëse për prodhimin, shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin e informacionit interoperabel me të dhëna gjeohapësinore, në kuadrin e zbatimit të direktivës 2007/02/CE "Inspire", në Shqipëri".

Struktura në fjalë do të jetë përgjegjëse ndër të tjera për përgatitjen e hartave unike (të standardizuara) në Republikën e Shqipërisë, e cila do të furnizojë me të tilla harta çdo institucion shtetëror të përfshirë në procesin e pronës. Në këtë mënyrë, të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e pronës do të punojnë me harta të të njëjtit standard, çka do të mundësojë shkëmbimin dhe koordinimin e informacionit hartografik. Kjo strukturë synohet të ngrihet brenda muajit gusht 2011 dhe synohet të ketë përfunduar përgatitjen e hartës unike standarde brenda muajit janar 2012. Kjo Agjenci parashikohet të ketë si fillim një personel prej 15 vetash. Kompetencat e kësaj Agjencie do të dihen me saktësi në momentin e krijimit të saj.

3. Ligjore

3.1 Do të përditësohet përmbledhja aktuale për çështjet e pronësisë, e cila është e përditësuar deri në vitin 2006. Ky proces do të mbikëqyret dhe koordinohet nga koordinatori përkatës pranë njësisë në fjalë. Ky koordinator do të ndihmohet nga Qendra e Publikimeve Zyrtare që është përgjegjëse për botimin e Fletore Zyrtare. Prosesi në fjalë përfundon brenda muajit dhjetor 2011.

3.2 Parashikohet që brenda vitit 2012, me ndihmën e institucioneve ndërkombëtare, të kryhet thjeshtimi dhe konsolidimi i legjislacionit për çështjet e pronësisë në sa më pak tekste ligjore të jetë e mundur, duke u parashikuar procedura të sakta dhe të drejtpërdrejta për fushën e pronësisë.

ALUIZNI përfundon procesin e kualifikimit të subjekteve që përfitojnë legalizim brenda vitit 2011. Mbi hartën e standardizuar, brenda periudhës shkurt 2012 - gusht 2012, do të pasqyrohen të gjitha pasuritë e legalizuara apo të përjashtuara nga legalizimi. Informacioni i kësaj harte do t'i vihet në dispozicion AKKP-së, në mënyrë që të jetë në gjendje të vlerësojë situatën në terren. Në këtë mënyrë AKKP-ja do të ketë informacionin e duhur për gjendjen e legalizimeve, me qëllim që të shmangë dhënien e vendimeve në të tilla zona.

Deri në fund të vitit 2012, KQT-ja përfundon shqyrtimin në rrugë administrative të të gjitha kërkesave dhe praktikave (përfshirë rastet që trajtohen për shkak të urdhërimeve të vendimeve gjyqësore). Vlen të sqarohet që pas fazës administrative do të vijohet me fazën gjyqësore të këtij procesi, e cila zgjat rreth 3-4 vjet në të gjitha shkallët e gjyqësorit dhe përfundimi i saj është i pavarur nga ekzekutivi.

Në funksion të përcaktimit të fondit për kompensim fizik sistematik:

ZRPP-ja duhet të mbarojë procesin e plotë të regjistrimit fillestar. Përveç zonave kadastrale që janë në proces regjistrimi fillestar dhe që e përfundojnë atë brenda vitit 2013, përfundimi i këtij procesi për 477 zonat e mbetura kadastrale, si dhe për pyjet e kullotat në të gjithë territorin e vendit varet nga sigurimi i fondit financiar të nevojshëm për këtë proces. Ky fond përlllogarit të jetë afërsisht 10 milionë euro për një total prej 678.800 pasurish.

METE do të identifikojë të gjitha pasuritë shtetërore që mund të shërbejnë për kompensim të ish-pronarëve me pjesëmarrje në privatizimin e këtyre pasurive (me blerje aksionesh).

Ministria e Mjedisit të përcaktojë fondin pyjor dhe kullor që do të shërbejë për kthim dhe kompensim fizik.

APKT-ja të përfundojë përcaktimin e kufijve të zonave me përparësi zhvillimin e turizmit dhe të hartojë studimet urbanistike për këto zona. Gjithashtu, të identifikojë, pronat që mund të shërbejnë për kthim dhe kompensim fizik.

B. Masat për një shërbim përmbartimor efektiv

Në kuadër të reformimit të Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit po angazhohet në realizimin e iniciativave të nevojshme ligjore e zbatuese, në funksion të përmirësimit të funksionimit dhe forcimit të kapaciteteve të këtij shërbimi. Masat, të cilat po ndërmerren janë:

a) Aplikimi i sistemit të kontrollit, i cili ka sjellë një vlerësim konkret në ecurinë dhe efektivitetin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, nga zyrat përmbartimore;

b) Krijimi i regjistrat *on-line* për hedhjen e të dhënave fillestare të titujve ekzekutivë të regjistruar për ekzekutim në Shërbimin Përmbartimor e Gjyqësor Shtetëror dhe Privat.

c) Krijimi i një sistemi të plotë për trajtimin dhe menaxhimin e çështjeve përmbartimore, së bashku me ngritjen e infrastrukturës së nevojshme në zbatim të këtij sistemi.

d) Përmirësimi i infrastrukturës nëpërmjet rikonstruksionit dhe përshtatjes së ambienteve të marra rishtazi për Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit, sigurimi i ambienteve dhe mjeteve logjistike të nevojshme në funksion të detyrës për zyrat përmbartimore.

e) Realizimi i trajnimit vazhdues, për periudhën 2009-2012, të përmbartuesve gjyqësorë, në vijim të marrëveshjes me Shkollën e Magjistraturës.

f) Nënshkrimi i marrëveshjeve ndër-institucionale për bashkëpunim.

a) Trajnimi i stafit të Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor

Në zbatim të detyrimit ligjor mbi trajnimin e përmbartuesve gjyqësorë, në marrëveshje me shkollën e Magjistraturës, është bërë e mundur përfshirja e tyre në programin e trajnimit vazhdues për periudhën 2009-2012.

b) Lidhur me implementimin e ligjit nr.8510/1999, rekomandohet që:

- Përmbajtja e ligjit të publikohet në faqet zyrtare të të gjitha institucioneve shtetërore;

- Të informohet dhe ndërgjegjësohet publiku i gjerë lidhur me zbatimin e këtij ligji me anë të publikimit dhe shpërndarjes së manualit “Mbi marrëdhëniet e individit me administratën publike”, si dhe fletëpalosje informimi pranë zyrave të informimit të publikut;

- Të konsiderohet mundësia e organizimit të një simpoziumi me aktorë të ndryshëm nga sistemi i drejtësisë, administrata publike, shoqëria civile etj.

VENDIM

Nr.351, datë 21.4.2011

PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË KORNIZËS SHQIPTARE TË KUALIFIKIMEVE DHE TË SEKRETARIATIT TEKNIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 4, 11 e 16, të ligjit nr.10 247, datë 4.3.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, më poshtë “Këshilli”, në ushtrim të funksioneve dhe të përgjegjësisë të përcaktuara në ligjin nr.10 247, datë 4.3.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, kryen këto detyra:

a) Siguron referimin e niveleve të kualifikimit kombëtar me kuadrin europian të kualifikimeve, në mënyrë që të lehtësojë krahasimet ndërmjet tyre;

b) Informon dhe këshillon grupet e interesit për lidhjen ndërmjet kualifikimeve kombëtare me kuadrin e kualifikimeve europiane me anë të sistemit kombëtar të kualifikimit;

c) Promovon, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare, arsimin e lartë, institucionet e arsimit dhe formimit profesional, partnerët socialë, sektorin e biznesit dhe ekspertët, pjesëmarrjen e palëve të interesuara në krahasim dhe përdorimin e kualifikimeve në nivel europian;

ç) Zhvillon strategjinë kombëtare për hartimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK);

d) Monitoron zbatimin e tyre dhe raporton në Këshillin e Ministrave çdo gjashtë muaj;

dh) Bashkërendon punën për zbatimin e politikave dhe të rregulloreve për zhvillimin e KSHK-së nga institucionet përgjegjëse, nëpërmjet udhëzuesve, kritereve dhe procedurave;

e) Zhvillon politika, kritere dhe procedura për pranimin, transferimin dhe progresin e individëve ndërmjet rrugëve të ndryshme të të nxënit;

ë) Vendosi ngritjen e një sistemi kombëtar për transferimin dhe mbledhjen (akumulimin) e krediteve;

f) Miraton dhe publikon nivelet dhe përshkruesit e niveleve të referencës në KSHK;

g) Vendosi ngritjen e komiteteve sektoriale për hartimin e standardeve të profesioneve, në përputhje me nivelet e KSHK-së;

gj) Miraton dhe publikon standarde të profesioneve, për përfshirje brenda KSHK-së;

h) Miraton dhe publikon kualifikime, së bashku me përshkruesit përkatës, për çdo nivel të kornizës;

i) Miraton dhe mirëmban listën kombëtare të kualifikimeve për të gjithë nënsektorët e KSHK-së;

j) Zhvillon politikën për akreditimin institucional, e cila mund të përfshijë edhe akreditimin e programeve, për të orientuar punën e institucioneve zbatuese në këtë drejtim;

k) Miraton politikat për vlerësimin dhe certifikimin, duke përcaktuar parimet kryesore, në të cilat mbështeten institucionet zbatuese dhe organet e tjera, të përfshira në zbatimin e KSHK-së;

l) Ngre grupe pune të përkohshme për trajtimin e temave specifike në fushën e arsimit dhe të formimit.

2. Funksionimi i Këshillit bëhet në përputhje me rregulloren, e cila miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Sekretariati teknik i Këshillit përbëhet nga 5 (pesë) punonjës të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe ka detyrat, si më poshtë vijon:

a) Menaxhon detyrat administrative dhe organizative të Këshillit të KSHK-së, duke përdorur grupe pune ekspertësh. Detyrat e caktuara kryhen në mënyrë bashkëpunuese;

b) Vendosi në dispozicion të Këshillit të KSHK-së materiale dhe dokumente lidhur me çështje që trajtohen në Këshill;

c) Përpunon informacionet e propozuara në mbledhjen e Këshillit të KSHK-së në formën e kërkuar për ekzekutim dhe ia paraqet ato kryetarit (ministrit);

ç) Mban procesverbalet e zhvillimit të mbledhjeve të Këshillit të KSHK-së, përgatit materialet që do të shpërndahen për mbledhje, mban korrespondenca lidhur me njoftime të ndryshme të anëtarëve të Këshillit, si dhe kryen shërbime të tjera;

d) Ruan të gjitha dokumentet, informacionet, raportet, studimet dhe materiale të tjera të paraqitura në formën zyrtare në mbledhjet e Këshillit të KSHK-së;

dh) Mirëmban bazën e të dhënave për kualifikimet e miratuara, sipas niveleve të referencës në KSHK;

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.353, datë 4.5.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR QAFË-KASHAR-RINAS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2010”, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qafë-Kashar-Rinas.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 2407 (dy mijë e katërqind e shtatë) m² tokë arë me vlerë 1 384 025 (një milion e treqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëzet e pesë) lekë, për objekt me sipërfaqe 49.5 (dyzet e nëntë pikë pesë) m² me vlerë 997 841 (nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dyzet e një) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për tokë arë dhe objekt, është 2 381 866 (dy milionë e treqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale në vlerën 291 000 (dyqind e nëntëdhjetë e një mijë) lekë do të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për tokë arë dhe objekt, është 2 381 866 (dy milionë e treqind e tetëdhjetë e një mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, e cila do të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.5.2011 dhe të përfundojë më 15.8.2011.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhen këtij vendimi, do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë të rifreskuar brenda afateve ligjore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve sipas pikave 6 dhe 7, të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë, pasi të ketë marrë konfirmimin pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen: procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
 DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

SEGMENTI RRUGOR “QAFË KASHAR-RINAS”

Nr.	Pronari			Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja për m ²	Çmimi l/m ²	Vlera lekë	Fshati	Vlera totale	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri									
1	Bashkëpronarët Bregasi	Ypi,	Alxhani,	1669	241/1	Arë	2407	575	1 384 025	Fushë-Prezë		Rikonfirmim
2	Adem	Islam	Dervishi	1167		Objekti (Godina e Pompave të Ujit)	49.5		997 841	Bërxull	997 841	Rikonfirmim

Shuma totale: 2 381 866

UDHËZIM
Nr.12/1, datë 26.5.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.12, DATË 18.5.2011 “PËR PROCEDURAT E ZBATIMIT TË LIGJIT NR.10418, DATË 21.4.2011 “PËR LEGALIZIMIN E KAPITALIT DHE FALJEN E NJË PJESE TË BORXHIT TATIMOR DHE DOGANOR””

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.10418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.12, datë 18.5.2011 “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor””, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në sesionin II. 4 “Falja e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, në pikën 2 “Personat fizikë dhe juridikë”, fjalët “...me kushtin që kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të paguhen brenda afatit të zbatimit të ligjit” shfuqizohen.

2. Në sesionin III “Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1.4 ndryshohet si më poshtë:

“1.4 Aplikuesi paraqitet personalisht, me dokument identifikimi pranë ZVRPP-së dhe depoziton në dy kopje formularin e aplikimit të punonjësi i ZVRPP-së. Ky i fundit shqyrton të dhënat e plotësuara në formular dhe dokumentacionin bashkëlidhur (nëse ka). Nëse të dhënat janë të sakta, punonjësi i ZVRPP-së nënshkruan formularin e aplikimit dhe një kopje të tij ia jep aplikuesit. Nëse ka pasaktësi në plotësim, fton aplikuesin t’i korrigojë. Punonjësi i ZVRPP-së nuk ka asnjë arsye që të refuzojë kërkesën për aplikim.

a) Tatimi i rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme do të llogaritet 1% e diferencës midis çmimit të rivlerësimit me çmimin e blerjes së pasurisë në kontratën paraardhëse të shitblerjes. Në rastet kur pasuria e paluajtshme e regjistruar në ZVRPP nuk ka një kontratë paraardhëse shitblerjeje, tatimi i rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme do të llogaritet sipas metodikës së përdorur në udhëzimin nr.9, datë 26.2.2008 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme”, të ndryshuar.

Gjatë plotësimit të formularit të aplikimit për rivlerësim të pasurisë së paluajtshme, zyra vendore e regjistrimit të pasurive llogarit masën e tatimit të rivlerësimit (pika 4 e formularit të rivlerësimit). Aplikuesi paguan në bankë, për llogari të Buxhetit të Shtetit të Ministrisë së Financave, tatimin 1% të rivlerësimit të pasurisë. Tatimi mbi rivlerësimin e pasurisë duhet të paguhet në momentin e kryerjes së aplikimit për rivlerësim. ZVRPP-ja, pasi bashkëlidh formularin e aplikimit për rivlerësim me mandatin e pagesës së tatimit nga aplikuesi, bën ndryshimet përkatëse brenda 10 ditëve në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Data e rivlerësimit të pasurisë është data e pagimit të tatimit të rivlerësimit të pasurisë. Ky ndryshim i njoftohet aplikuesit, sipas kërkesës së tij në ZVRPP, për shërbimin e lëshimit të kopjes së kartelës së pasurisë apo vërtetimit të pronësisë së paluajtshme.

b) Në rast se individ i do të bëjë kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme pas rivlerësimit, tatimi për kalimin e së drejtës së pronësisë llogaritet si diferencë e çmimit të shitjes dhe çmimit të rivlerësuar të pasurisë. Në rast se kjo diferencë është negative, individ nuk paguan tatim.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.13, datë 26.5.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.5, DATË 30.1.2006 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.10 343, datë 28.10.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Në deklaratën individuale vjetore për individët e huaj, te pjesa “Për mënyrën e plotësimit të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të individëve të huaj në Republikën e Shqipërisë, pika 23 ndryshohet, me përmbajtjen:

“23. Tatimi mbi pagën plotësohet për shumën e tatimit mbi pagën dhe shpërblimet mbi pagën të paguar gjatë periudhës tatimore. Në rastin e të vetëpunësuarit që kryen veprimtari të biznesit të vogël, kjo kuti plotësohet me shumën e tatimit të paguar nga zhvillimi i kësaj veprimtarie (kutia nr.22 e formularit të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël).”

Ku udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 30.5.2011
Doli nga shtypi më 31.5.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 24 lekë